



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 129, datë 23.12.2013

**MBI
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 55, të Ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 7, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Ndryshimin e nenit 7 të statutit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., si më poshtë:

Neni 7
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 592.050.000 lekë (pesëqind e nëntëdhjetë e dy milion e pesëdhjetë mijë) lekë. Ai është i ndarë në 59.205 (pesëdhjetë e nëntëmijë e pesëdhjetë) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 10.000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo aksion. Aksionet janë të numëruara nga numri 1 deri 59.205, përfshirë numrin e fundit të aksionit.

Pjesëmarrja e aksionarëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

	Aksionari	Përqindja	Nr. i aksioneve	Vlera në lekë
1	<i>Kadri Morinaj</i>	62,86	37.217	372.170.000
2	<i>Shoqëria “Euroalba E.A.” sh.p.k.</i>	32,70	19.359	193.590.000
3	<i>Xhevdet Morina</i>	3,13	1.853	18.530.000
4	<i>Panajot Gjikhuri</i>	1,31	776	7.760.000
	TOTALI	100,00	59.205	592.050.000

Aksionarët kanë të drejtën e fitimit (dividentit) mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë në shoqëri.

Shoqëria është krijuar dhe funksionon me motiv fitimin, megjithatë në rastet e humbjes ajo mbulohet gjithashtu proporcionalisht me kontributin themeltar në aksione”.